



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:056576

Datë: 11.06.2024

Numri i dokumentit: 05810648

KPPP.nr.915/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit Komisioni i Pavarur i Mediave, me seli në rr. “Perandori Justinian”, nr.124, në Prishtinë, kundër debitorit “Radio Kosova 2” NRB: 90000535, me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga drejtori A.B., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.532/2018 të datës 02.02.2018 të Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj nga Prishtina, jashtë seancës, me datë 11.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Radio Kosova 2”, ANULOHET urdhri përmbartimor P.nr.532/2018 i datës 02.02.2018, i Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komisioni i Pavarur i Mediave, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.532/2018 të datës 02.02.2018, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht faturës: nr.001298 të dt. 03.03.2016, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që të ia paguaj kreditorit në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës shumë prej 10,080.00 € si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore në pajtim me Udhëzimin Administrativ UA-MD Nr.06/2014, nën kërcënimin të përmbartimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar se fatura e cila është bashkëngjitur nuk e ka marr cilësinë e

përmbartueshmërisë, nuk i përmban elementet e një dokumenti të besueshëm sipas LPP-së, duke shtuar se gjatë periudhës kontestuese e deri në paraqitjen e propozimit për përmbartim nga ana e kreditorit, kreditori dhe debitori, asnjëherë nuk kanë bërë barazimin e gjendjes financiare, duke theksuar se nga ky fakt propozimi i kreditorit konsiderohet jo real.

Me tutje, ka shtuar se Radio Televizioni i Kosovës është autoritet publik, i cili pranon ndarje buxhetore dhe nuk mund të bëjë pagesa më shumë se që parashihet me planin buxhetor, e ka konsideruar të nevojshëm rishikimin e përbashkët nga ana e kreditorit dhe debitorit me qëllim të barazimit të gjendjes financiare. Andaj, ka konsideruar që meqenëse propozimi për përmbartim nga ana e kreditorit është paraqitur para barazimit financiar, fatura kontestuese nuk paraqet dokument të besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbartueshmërisë. I ka propozuar gjykatës që të pranohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri i përmbartuesit.

Kreditori brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit si të pabazuara duke shtuar se fatura e lëshuar nga KPM i plotëson të gjitha elementet e përcaktuara si dokument i besueshëm, duke shtuar se debitori ka qenë i obliguar që të kryej pagesën e tarifës për licencë për vitin 2016, deri me datë 31.03.2016.

Me tej, ka shtuar se debitori nuk ka parashtruar asnjë dëshmi me të cilën e argumenton se nuk ka borxh ndaj kreditorit, duke theksuar se pretendimet e debitorit përmes prapësimit nuk hyn në shkaqet e prapësimit të parapara me nenin 71 të LPP-së, e të cilat nuk e pengojnë kreditorin në realizimin e kërkesave kreditore. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit si i pa bazuar, të mbetet në fuqi urdhri i lejimit P.nr.532/18 i datës 02.02.2018, dhe të obligohet debitori që t'i paguaj shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim sipas tarifave të parapara.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, lidhur me këtë çështje përmbartimore me Aktvendimin PPP.nr.943/18 dt. 29.03.2019, ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit dhe e ka shfuqizuar urdhrin përmbartimor P.nr.532/18 të datës 02.02.2018.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, me aktvendimin K.DH.SH.II.nr.722/22, të datës 04.04.2023, ka aprovuar si të themeltë ankesën e debitorit, ndërsa ka anuluar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, me nr. PPP.nr.943/2018, të datës

29.03.2019 dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje në Gjykatën Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe vërejtjeve të dhëna sipas aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura me nr.001298, e datës 03.03.2016, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti – Fatura në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta nuk përmban as nënshkrimin e pranuesit – debitorit dhe nuk ka dëshmi se e njëjta është pranuar nga debitori. Andaj, duke qenë se debitori nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën e po ashtu fatura nuk përmban as kohën e përmbushjes së detyrimit monetar, si e tillë e njëjta nuk mund të shërbej si dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbartueshmërisë.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura nuk i plotëson kushtet e përcaktuara për zbatimin e përbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm edhe për faktin se në propozimin për përbarim nuk është përcaktuar fare afati i përmbushjes së detyrimit, siç parashihet me dispozitën e nenit 40 par 1.2 të LPP-së, i cili përcakton se Propozimi për përbarim në bazë të dokumentit të besueshëm duhet të përmbajë *“kërkesën që organi përbarues ta detyrojë debitorin e përbarimit që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh, kurse në kontestet nga raportet ku ekziston kambiali dhe çeku brenda afatit prej tre (3) ditësh, nga dita në të cilën i dorëzohet aktvendimi ta përmbushë detyrimin bashkë me shpenzimet e caktuara”*.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përbarim, e mbi bazën e të cilit Përbaruesi privat ka lejuar përbarimin, nuk ka tipare të përbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përbaruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 915/23, datë 11.06.2024.

Gjyqtari
Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.